



UDHËZUES I PRINDIT PËR NIVELET E LEXIMIT

KOPËSHT DERI KLASA 3

NDIHMONI FEMIJËN TUAJ TË AFTESOHËT NË ÇDO NIVEL TË LEXIMIT

Prindër, gjeni **NIVELIN E LEXIMIT TË PAVARUR** të fëmijës tuaj në dëftesën e tij/saj.

Një nivel i leximit të pavarur është niveli në të cilin një fëmijë mund të lexojë me lehtësi pa ndihmën e një të rrituri.

SYNIMET E LEXIMIT TË PAVARUR SIPAS KLASËS

NIVELI	PARA-LEXIMI	A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S		
				SYNIMI NË PËRFUNDIM TË KOPËSHTIT						SYNIMI NË PËRFUNDIM TË KLASËS SË 1				SYNIMI NË PËRFUNDIM TË KLASËS SË 2				SYNIMI NË PËRFUNDIM TË KLASËS SË 3				

KOPËSHT

PARA-LEXIMI:

- Përputh një figurë me një fjalë.
- Emërton disa shkronja të mëdha dhe të vogla.
- Bën dallimin midis numrave dhe shkronjave; dhe shkronjave e fjalëve.
- Shoqëron disa shkronja dhe tinguj me emrat e tyre.
- Identifikon disa fjalë familjare dhe shënja të mjedisit (p.sh, shënja STOP).
- Përshkruan me detaje ilustrimet e librave.
- U përgjigjet pyetjeve rreth një libri të lexuar me zë.
- Dikton tregime për një të rritur.

NIVELI A:

- Gjen fjalë të njohura në një tekst.
- Dallon disa fjalë të përditëshme.
- Dallon në një tekst fjalët e përditëshme.
- Bën parashikime bazuar në informacionin e ilustrimeve.
- Lexon nga e majta në të djathtë një rrjesht të shtypur.
- Përputh një fjalë të folur me një të shtypur në tekst.
- Mban mend informacion të rëndësishëm nga një tregim.

NIVELI B:

- Njeh me shpejtësi shumë fjalë.
- Përdor shkronjën e parë të një fjale, bashkë me ilustrimin, për të nxjerrë fjalët e sakta
- Njeh disa fjalë pamore.
- Me leximin e një rrjeshti, kthehet në të majtë të rrjeshtit pasardhës.
- Diskuton pas leximit tekstin duke kujtuar detajet më të rëndësishme në tregim.
- Parashikon përfundimin e një tregimi bazuar në leximin e fillimit dhe mesit të ndodhisë.
- Identifikon një tingull dhe e lidh atë me një shkronjë.

NIVELI C:

- Njeh 10 ose më tepër fjalë pamore në një vazhdimësi teksti.
- Përdor për komunikim fjalë të njohura dhe nxjerr fjalë të reja.
- Bën lidhje midis fjalëve, tingujve, ose modeleve të spellimit.
- Rilexon për kërkimin e informacionit.
- Vë re dhe përdor shënjat e pikëzimit, kur lexon me zë.
- Identifikon një vijueshmëri të thjeshtë të ngjarjeve në një tregim.
- Bën parashikime mbështetur në informacionin e mbledhur gjatë leximit
- Kupton lidhjen e ideve të tekstit me titullin.
- Nxjerr kuptimin e disa fjalëve të reja, që janë të mundëshme në kontekst.

NIVELI D:

- Njeh 20 ose më tepër fjalë pamore në një tekst me 3 deri 6 rreshta.
- Rilexon një fjali për korigjimin e gabimeve gjatë leximit.
- Përdor kuptimin e strukturës gjuhësore për nxjerrjen e fjalëve të reja.
- Reflektton në shënjat e pikëzimit përmes pauzave, kur lexon me zë.
- Konkludon dhe flet për ndjenjat e karaktereve.
- Ndan opinione për tekstin në tërësi (fillimi, karakteret, përfundimet).
- Përgjithëson problemin në një tregim të thjeshtë dhe flet për zgjidhjet.

NIVELI E:

- Përdor fillimin dhe mbarimin e fjalëve për nxjerrjen e kuptimit të fjalëve të reja.
- Njeh shpejt dhe me lehtësi shumë fjalë të rregullta dhe pamore.
- Kupton dhe flet për rendin e thjeshtë të ngjarjeve në një tregim.
- Demonstron lexim të rrjedhshëm gojor.
- Njeh dhe përdor shënjat e pikëzimit përmes pauzave dhe intonacionit të zërit.
- Parashikon përfundimin e një tregimi bazuar në leximin e fillimit dhe mesit të ndodhisë.
- Bën lidhjet dhe diskuton sipas përvojës së tij temat e tregimit.
- Flet rreth ndjenjave të karaktereve.
- Bën dallimin midis tregimeve/teksteve si krijimtari (fantazi) ose reale (e vërtetë).
- Lexon pa tregues leximi.

NIVELI F:

- Njeh 50 ose më tepër fjalë pamore.
- Ndërsa lexon, njeh dhe përdor pjesët e fjalës, fjalët me rimë dhe bashkimin e bashkëtinglloreve për zgjidhjen e fjalëve.
- Përdor tingujt që lidhen me zanoret dhe bashkëtinglloret për zgjidhjen e fjalëve.
- Përdor veçoritë e thjeshta të tekstit (titujt, kreun, tabelën e përmbajtjes).
- Rilexon fjalinë, ose frazën për vetë korigjim, ose konfirmim.
- Kryen një përmbledhje gojore të tekstit me detajet e duhura.
- Identifikon dhe lexon disa fraza si grupime fjalësh.
- Bën parashikime bazuar në njohuritë e karaktereve.
- Flet për ndjenjat dhe motivet e karaktereve.
- E kupton që një tregim përbëhet nga fillimi, mezi dhe përfundimi.

NIVELI G:

- Njeh shpejt dhe automatikisht, 75 ose më tepër fjalë pamore
- Përdor bashkimet (p.sh., sl, sn, fr) dhe dyshkronjat (p.sh., sh, th, wh) për fjalët e reja.
- Hulumton për faktet e veçanta në tekstet informative.
- E ka të qartë, se kur duhet më tepër informacion për kuptimin e tekstit.
- Ndjek dhe diskuton ngjarjet e ndryshme në një tregim.
- Demonstron theksin e duhur në fjalët e fjalisë.
- Mbështet parashikimet me dëshmi nga teksti, ose njohuritë e mëparëshme.
- Bën lidhje midis teksteve/temave të ngjashme.
- Identifikon shkakun dhe efektin që nënkuptohet në tekst.
- Përdor dhe interpreton informacionin nga ilustrimet për nxjerrjen e kuptimit.

NIVELI H:

- Njeh shpejt dhe automatikisht, 100 ose më tepër fjalë pamore në vazhdimësinë e tekstit
- Tregohet elastik për kuptimin e fjalëve të reja duke i ndarë ato, duke nxjerrë kuptimin.
- Përdor kontekstin dhe ilustrimet për nxjerrjen e kuptimit të fjalëve të reja.
- Vë re, kërkon dhe diskuton informacionin, që është i rëndësishëm për kuptimin.
- Përmbledh tregime me ngjarje të shumëfishta.
- Përdor gjuhën, strukturën dhe kuptimin për mbështetjen e rrjedhshmërisë dhe formulimin.
- Identifikon informacionin e ri dhe e lidh me njohuritë e mëparëshme.
- Demonstron mësimin e përmbajtjeve të reja nga leximi.
- Pajtohet, ose nuk pajtohet me idetë e një teksti.
- Përdor titujt dhe temat për kërkimin e informacionit.

NIVELI I:

- Njeh shpejt dhe automatikisht, 100 ose më tepër fjalë pamore në librat me kapituj për fillestarët.
- Lidh fjalët që nënkuptojnë të njejtën gjë, ose sinonimet e tyre, për nxjerrjen e kuptimit nga teksti.
- Kujton informacionin, ose një seri ngjarjesh, për kuptimin e përfundimit të tregimit.
- Zgjidh me shpejtësi dhe automatikisht më shumë fjalë në tekst.
- Në një shkallë të përshtatëshme lexon në mënyrë të pavarur.
- Diskuton lidhjet midis tekstit dhe vetes.

KLASA 2

NIVELI J:

- Lexon rrjedhshëm, ngadalsohet në fjalët e reja dhe më pas fiton rrjedhshmërinë përsëri.
- Përdor titujt e kapitujve për parashikimin e përmbajtjes – kupton problemin dhe zgjidhjen e tij në tregim.
- Bën parashikime të karakterit bazuar në veçoritë e tyre.
- Bën lidhje midis tekstit dhe teksteve të tjerë të lexuar.
- Përgjithëson ndjenjat e karaktereve nëpërmjet leximit të dialogëve të tyre.
- Konkludon për shkaqet e problemeve, ose përfundimeve në krijimtari artistike dhe dokumentare.
- Hamendëson se si karakteret mund të sillëshin ndryshe.
- Lexon dhe kupton fjali të gjata me 10, ose më shumë fjalë.

KLASA 3

NIVELI M:

- Kupton fjalët me 2 ose 3 rrokje dhe fjalët më shumë përshkruese.
- Lidh fjalët që nënkuptojnë të njejtën gjë, ose sinonimet e tyre, për nxjerrjen e kuptimit nga teksti
- Fillon të njohë fjalët e reja dhe interesante, i përdor aktivisht ato me gojë dhe me shkrim.
- Në diskutimet dhe interpretimet shkon përtej ndodhive të tekstit.
- Proçedon në fjalitë e gjata (mbi 15 fjalë) me disa emra, folje dhe mbiemra.
- Vazhdimisht, ndërsa lexon, kontrollon kuptimin, ose kërkon për informacion.
- Përdor burime të shumta informacioni për mbështetjen e rrjedhshmërisë.
- Demonstron kujdes ndaj shenjave të pikëzimit dhe i lexon dialogët me shprehje.
- Bën lidhje midis tekstit dhe teksteve të lexuara më përpara.
- Bën dallimin midis informacionit të njohur dhe të ri.
- Demonstron ndryshimin e perspektivës, ndërsa ngjarjet zhvillohen në një tregim.

NIVELI K/L:

- Nxjerr kuptimin e fjalëve duke përdorur pjesët e saj, parashtesat (p.sh., pre, un, dis, re), mbaresat (p.sh., ed, ing).
- Kupton fjalë më përshkruese.
- Njeh dhe përdor grafika të tilla si etiketat, diagramat, hartat, tabelat dhe titrat.
- Kupton fjali më të gjata (mbi 15 fjalë).
- Kujton karakteret dhe ngjarjet e një teksti të gjatë, që lexohet gjatë disa ditëve (p.sh., kapitujt e librave).
- Vetëkorrigjon gabimet të cilat shkaktojnë humbjen e kuptimit.
- Identifikon idetë e rëndësishme në një tekst.
- Përmbledh idetë nga teksti dhe lidhjet e tyre.
- Në një shkallë të mirë lexon në heshtje.
- Përligj parashikimet duke përdorur prova.
- Nxjerr përfundim për shkakun dhe pasojën duke lexuar për karakteret dhe ngjarjet.
- Nxjerr përfundim për ndjenjat e karaktereve duke përdorur dëshmi nga teksti.
- Njeh stilin e shkrimtarit, pasi ka lexuar disa libra nga i njëjti autor.

NIVELI N:

- Kupton fjalët me 2 ose 3 rrokje dhe fjalët më shumë përshkruese.
- Lidh fjalët që nënkuptojnë të njejtën gjë, ose sinonimet e tyre, për nxjerrjen e kuptimit nga teksti
- Fillon të njohë fjalët e reja dhe interesante, i përdor aktivisht ato me gojë dhe me shkrim.
- Në diskutimet dhe interpretimet shkon përtej ndodhive të tekstit.
- Proçedon në fjalitë e gjata (mbi 15 fjalë) me disa emra, folje dhe mbiemra.
- Vazhdimisht, ndërsa lexon, kontrollon kuptimin, ose kërkon për informacion.
- Përdor burime të shumta informacioni për mbështetjen e rrjedhshmërisë.
- Demonstron kujdes ndaj shenjave të pikëzimit dhe i lexon dialogët me shprehje.
- Bën lidhje midis tekstit dhe teksteve të lexuara më përpara.
- Bën dallimin midis informacionit të njohur dhe të ri.
- Demonstron ndryshimin e perspektivës, ndërsa ngjarjet zhvillohen në një tregim.
- Ndjek dhe kujton një seri ndodhishë dhe problemin e tregimit si edhe zgjidhjen në një tekst më të gjatë, në mënyrë që të kuptojë përfundimin.
- Bën lidhje midis tekstit dhe teksteve të lexuara apo dëgjuar më përpara dhe i demonstroi në shkrim.

NIVELI O:

- Kupton domethënien konotative (dytësore) të fjalëve (p.sh., “shtëpi” është një vend i rehatisë dhe ngrohtësisë).
- Zgjidh kuptimin e fjalëve të vështira duke përdorur njohuritë e mëparëshme.
- Proçedon në tekste që kanë shumë rrjeshta në një faqe
- Formulon pyetje dhe kërkon përgjigje ndërsa është duke lexuar.
- Kërkon informacion duke përdorur mjete të tilla si: ilustrimet, hartat, tabelat, titrat, tabelat e përmbajtjes, indeksi, fjalori dhe titujt.
- Përmbledh me shkrim, ose me gojë tregime të gjata me shumë episode.
- Përdor strukturën e tekstit për parashikimin e përfundimit të tregimit.
- Bën një varg të gjatë parashikimesh bazuar në njohuritë e mëparëshme, ato të përmbajtjes dhe të tekstit.
- Ndjek karaktere të shumëfishta në një tregim.
- Nxjerr shkaqet e problemeve, ose përfundimeve në krijimtari letrare dhe dokumentare.

DASHURIA E FEMIJËS TUAJ PËR LEXIM FILLON ME JU.

- Bëjeni leximin një aktivitet të gëzuar familjar.
- Kur bëni zgjedhje librash, mendoni për nivelin e leximit të fëmijës dhe interesat e tij.
- Bashkohuni me mësuesit. Silleni këtë fletushkë në takimin e prindërve tuaj.
- Ndhmoni që fëmija të shkojë për çdo ditë në kohë, në shkollë. Leximi mësohet në mëngjes.

Për ide të shkëlqyera se si të ndihmoni fëmijën të lexojë në nivelin e klasës së 4_t, vizitoni: Readby4th.org.



THE SCHOOL DISTRICT OF
PHILADELPHIA

